

Argjend Hasani
SPIRALJA E AGONISË
(Prozë dhe poezi)

Botues

Prishtina PRESS

Redaktor

Vilson Culaj

Recensent

Prend Buzhala

Lektor

Isuf S. Sadriu

Disejني dhe faqosja

TRIMDON

Studio Design

Shtypshkronja

“Lena Grafik”

Prishtinë

2016

Ribotim

Argjend HASANI

**SPIRALJA
E
AGONISË**

PROZË DHE POEZI

**Shtëpia Botuese
PRISHTINA PRESS**

**PRISHTINË
2016**

*Kujtova për një çast,
rrotat e nostalgjisë,
që kishin përshkruar,
rrugët me kalldërm,
që unë tani,
nuk po i njihja më.*

Fjala e redaktorit

Mr. Vilson CULAJ

PROZË DHE POEZI TË NDËRTHURURA ME MJESHTËRI DHE ME PËRLOT MESAZHE

Vëllimi me prozë dhe poezi me titull „Spiralja e Agonisë“ e autorit Argjend Hasani, shpërfaqë elementet e natyrshme të një vije racionale dhe emocionale njerëzore përmes vargut poetik dhe prozës, duke manifestuar bindshëm antagonizmat njerëzore me bagazhin e ecejakeve shpirtërore, ku autori me mjeshtërinë e tij ka artikuluar qartë realitetin diskret të një shoqërie të brishtë dhe jo kuptimplotë.

Mendjeprehtësia e tij e begatimit të artit të komunikimit në relacionin individ-masë në raport me jo koshientët, hedhë në dritë përmes prozës dhe poezisë, akumulimin dhe pritjen e stërgjatur me premisë erupcionin social, si pasojë e tejf(r)yerjes nga neglizhenca dhe mungesa e rikthimit në identitet dhe krenari individuale dhe kolektive.

Shkrimtari Argjend Hasani, i takon plejadës së shkrimtarëve i cili me kreativitetin e tij si në kontekstin kohor dhe hapësinor në rrafshin vertikal dhe horizontal arrinë që përmes vargut poetik të zbërthej raportet e

”tendosura”, disharmonike në shoqërinë tonë nëpërmes një fuqie të mistershme mbresëlënëse kreative.

Me penën e tij, ia ka arritur që të sjellë tek lexuesi porosi përmes vargjeve të thukta e përmbajtësore në kontekst të mbarëvajtjes dhe respektit reciprok ndër gjenerata pa marrë parasysh vendin, moshën, gjininë apo pozitën në shoqëri.

Prandaj, mesazhi i shkrimtarit Argjend Hasani në këtë vëllim poetik është që të qëndrojmë indiferentë ndaj arrogancës, neglizhencës, urrejtjes dhe injorancës, ndërsa të fillohet të mbillet dhe të kultivohet sa më shumë ndër njerëz dashuria, zemërgjërësia, bujaria, besnikëria, çiltërsia, e mbi të gjitha virtyti i faljes dhe akceptimit të botës reale dhe seriozitetit maksimal në kryerjen e obligimeve dhe detyrave në nivel të përgjegjësisë morale njerëzore. Ky është nektari nëpër të cilin duhet të hapëroj dhe absorboj secili njeri.

Kjo vepër mund të shërbej si thirrje dhe udhërrëfyes në koshiençë dhe vetreflektim personal dhe kolektiv.

VALLJA E ÇMENDUR

Ka kohë që kur gjuha servile,
Lëpin lëmshin e smirës,
Duke sfiduar çiltërsinë.

Me imagjinatën e mjegullës së mbarsur,
Kapet hëna me shuplakën e dorës,
Spërkaten lulet me helmin e tradhtisë.

Në skajin tjetër, dielli vë një sy gjumë,
Si për ironi nata heq vellon e turpit,
Dhe ne hedhim vallen e çmendur.

Pa pushuar, ngremë gotën për fëlliqësinë e
radhës,
Ngremë gisht kundër fatit tjetër,
Pa e ditur se po i ngremë vetes litar.

LABIRINTI

Sot, nesër apo pasnesër,
Provojmë të djeshmen.

Mendja humbet kot fare,
E mori furtuna, mbeti e palexuar.

Ëndrrat e reja më nuk lindin,
Ato mbeten peng i së kaluarës.

Ndryshuan rregullat e lojës,
Ritmet e jetës dolën nga takti.

Këmbët mbetën të shtangura,
Nuk ecet dot me paterica,
Nëpër labirintin e së ardhmes.

GADISHULLI IM

Në ëndrrat e mia,
Itinerari i udhëtimeve,
Nuk ka të ndalur.

Ende kërkuj,
Parajsën e humbur,
Që vetëm tek ti e gjeja.

Tani trokas,
Në ndërgjegjen time,
Për gabimin e RADHËS.

Do marr në dorë timonin e anijes,
Do ikë nga ishulli i vetmisë,
Dhe do i kthehem gadishullit tim.

TYMI I VOTRËS SË FIKUN

Sytë e tu plot mallëngjim,
Qajnë mbi gjoksin tim,
Derisa unë po kërkoja,
Dallgët e lumit të tharë,
Fletët e rëna,
Nën borë.

Kujtova për një çast,
Rrotat e nostalgjisë,
Që kishin përshtuar,
Rrugët me kalldërm,
Që unë tani
Nuk po i njihja më.

Shtëpitë ishin kërrusur,
Ishin veshur me petkun e harresës,
Dhe ashtu i trishtuar,
U ktheva,
Tek tymi i vatrës së fikur,
Jetën për ta rinuar.

*Miq, zbulojeni djallin që ju njeh,
mos humbni nga frika fare,
se do ju pushton tmerrësisht ligësia.*

DIELLI QË LINDË NË PËRENDIM

Nga një fije e hollë,
Ishin bërë dy,
Nga dy -
Tridhjetë e dy.

Nga një mizë,
Ishte bërë një ka,
Nga një shkop -
Një tra.

Dielli që lind në perëndim,
Perëndon në lindje,
Në një ditë të ftohtë,
Në një natë tre syresh, të ngrohtë.

Bota është e madhe sa veja,
Mbi supe mund ta mbaj vetëm dehja,
Kontrast përfundimesh,
Fillim pa fund gabimesh.

ZBULOJENI DJALLIN QË JU NJEH

Isha zgjuar ngadalë,
Nga shtrati i vdekjes,
Dhe po ju vështroja.

Po ju shihja kur këputët,
Petalet e kuqe të trëndafilit,
Dhe e bëtë jetën skëterrë.

Fjalë urtin përçmuat,
Me gotën e helmatisur,
E gëlltitët si ujqër.

U fundosët në pusin e thellë,
Të lavires së rjepur,
Duke iu qasur epshit të çmendisë.

Flokëbardhën e bukur,
E poshtëruat egërsisht,
çnjerëzisht ia vodhët virgjërinë.

Miq, zbulojeni djallin që ju njeh,
Mos humbni nga frika fare,
Se do t'ju pushtojë tmerrësisht ligësia.

Unë do të kthehem sërish,
Në shtratin e prehjes,
Por, juve po ju lë barrën e burrnisë.

TAMPON ZONË

Doli, s'doli,
Erdhi, s'erdhi,
Shpëtoi, s'shpëtoi,
Fshatari, qytetari,
Bujku, zyrtari,
Fëmija, nëna,
Plaku e plaka,
Jetimi e flaka,
Babai, loti,
I tillë ishte,
Trishtim moti.

I gjalli i vdekur,
I vdekuri i gjallë,
Vinte erë mortje,
S'kish më fjalë,
E ndjeve, s'e ndjeve,
E dite, s'e dite,
Këtë skëterrë,
Fund, e fillim rrite.

Kanibal ishte,
Zemër katili,
I ndezur fitili,
Po nuk e fikëm,
Meduza rigjeneron.

MOS SHKRUAJ KËSHTU!...

Nga retë e dendura,
Resh shiu i lodhur,
Që ujit shpresën.

Mos shkruaj kështu!

Bie shi për të larë,
Llumin e mendjeve,
Të ngulfatur nga pluhuri i kohës.

Mos shkruaj kështu!

Bien rrebeshe shiu qëmoti,
Mbi ata shumë skamnorë,
Që nuk kanë kulm mbi kokë.

Atëherë, shkruaj dhembjen,
Që të ngjallim zemërgjerësinë,
Që ta ndjejmë së bashku lirinë.

ANONIM

Mbrëmjen
E mbuloi mjegulla,
Nusja fluturoi,
Mbi karvanin e dasmorëve.

Vallja
Ngriu fytyrat,
Dhëndri u fundos,
Në botën e margjinave.

Kitara
Rrihte telat,
Nën akordin
E tragjikomedisë.

Qifti
Ishte anonim,
Një tablo pa të ardhme,
Një hije pa njeri.

MIKU IM

Nëse është tharë një mund,
Miku im besnik,
I ndihmo vëllazërisht.

Nëse është ndarë një qift në dysh,
Miku im bujar,
I bashko sërish, miqësisht.

Nëse shkon në vijën e zjarrit për atdhe,
Miku im krenar,
Iu bashko trimërisht.

Të mirën dhe të keqen,
Miku im,
Ta ndajmë burrërisht.

ATË DITË

POST MORTUM

(Humanistit dhe veprimtarit të dalluar
Nipit tim Hajredin Zeqiri)

Atë ditë,
Edhe qielli ishte ngrysur,
Ishte mbytur i tëri në vaj,
Në heshtje pa pushim qante.

Atë ditë,
Fjollat e borës së "zezë",
Pasuan shiun e rebeluar,
Dhe ngrenë vellon e zisë.

Atë ditë,
Pikëllimi shihej kudo,
Në fytyrën e secilit,
Të njohurve dhe të panjohurve.

Atë ditë,
Ndjehej dhimbje,
Si asnjëherë më parë,
Në lumin e gjatë të njerëzve.

Ishe vigan,
Bujar e human,
Tokë e Alpeve tinëzare,
Ishe e pamëshirshme ndaj teje,
Në lulen e rinisë.

E shtunë, 4 dhjetor 2010
Cernicë-Gjilan

*Ai nuk ishte anonim,
kishte një ÇEKAN dhe një DRAPËR,
që rrëzonte murin e djersës sonë.*

RETRO(PER)SPEKTIVË

Në orët e vona,
Ndalova në stacionin e kujtesës,
Kujtova të kaluarën e mbarësuar,
E ardhmja ishte për së vërteti enigmë.

Më shoqëronte gota,
Akrepat e orës shprisheshin,
Po diktonin kapitujt,
Potpuri të pakënduara.

Mozaiku i mendjes,
Më trandi befas zemrën,
Refrenet e memories po rikthehen,
Dhe për një çast, shpërthen vullkani i dhembjes.

E kapa dinakërisht të ardhmen,
E shkuara të qetë s' më linte,
Më ishte bërë lak në fyt,
Kisha bërë hesap pa hanxhiun.

KËRSHËRI E PANGOPËSISË

Dikush në muzgun e natës,
Ngrysej kokë e bisht dinakërisht,
Dhe bredhte si një qen endacak.

Në natën e vonë,
Zgjaste duart e pista,
Në mozaikun e shenjtërisë.

Ai nuk ishte anonim,
Kishte një ÇEKAN dhe një DRAPËR,
Që rrëzonte murin e djersës sonë.

Ishte dikush që nuk lahej dot,
Që edhe dijen, e kishte vënë në kurth,
Dhe pangopësinë, e salutonte.

NË EPITAF

Ende jeton?

Thanë se ti kishe mbetur e gjallë,
Vetëm me iniciale në epitaf.

Se kishte rënë një kometë,
Të kishte katandisur përgjithmonë.

Me gënjeshtër të kishin granatuar,
Që të mos hysh edhe ti në epokën,
E shekullit XXI.

Ti ishe e gjallë,
Madje në anën tonë.
Kishim frikë se mos shkriheshe si bora,
Por ti ishe aty,
Si feniks i shpresës.

U shfaqe në fundin e tunelit,
Mbi majat e thepisura kalërove,
Kur e kishim më së vështiri,
Të patëm pranë.

VETËM POETI...

Nuk mund ta ndaja jetën me ata,
Që donin ta ndanin me mua.

Në repertuarin e tablove,
Të ulur në errësirën e acartë,
Rrinin pasagjerët e verbër.

Në djepin e zbrazët,
Dëgjohej një klithmë e heshtur,
Që po tundte kambanën e turpit.

Vetëm poeti aq larg mund të shkonte,
Pa grafitin e lapsit,
Vuajtjet mund t'i shkruante.

**RRËNJËT ATY
NUK KISHIN LINDUR**

Si mund të përkthehet,
Një zemër,
Në tjetër gjuhë.

Rrënjët aty nuk kishin lindur,
Por jeta i kishte kapërdirë me vete,
Në thellësinë e kopshtit të saj.

Pa dashje, hija jote
Ishte qepur me trupin x,
Dhe po hidhnit vallen.

Mozaiku prej endacaku
Kishte humbur fare ndër mjegull,
Vetëm shpresa e mbante gjallë.

Në karvanin e jetës
Zënë shtat dhe rritë,
Shpresa e pesimizmi,
Dashuria e urrejtja,
Gëzimi e hidhërimi.

Sikurse ikën

Gjurmët e hapave buzë detit,

Ikin vitet pas njëra-tjetrës,

Ndërsa ne përcjellim tek të tjerët

Stafetën e nostalgjisë.

Ndoshta njerëzit

Janë jetëra të jetuara

Në spiralen e agonisë,

Por lan veprat

E të (mos) qenit njeri.

PELLGU I HARRESËS

Fytafyt u ndeshët
Me teket mitike
Në tehet e kohës.

Nuk duruat dosat
Që t'jua vidhnin dritën
Në rininë e brishtë.

Nëpër mejdane
Vërshuat si viganë,
Duke e vrarë robërinë.

Sot, si për kob,
Bie daullja e lakmisë,
Për vallen e shthurjes.

Të ngujuar ju lanë,
Në pellgun e harresës,
Dhe “ata” mëkatet i lajnë me turp.

UVERTYRË LIRIE

Simfoni e mynxyrosur,
E rrahur e vrarë ndër shekuj,
Lëviz orkestrën,
Vëre në lojë gazin,
Harro vajin,
Kuro plagët,
Fashite zemrën
Në liri.

Tronditi shpirtrat,
Premtimin mbaje,
Forcë titanike,
Thuaja këngës.

Thuaja këngës,
Së shumë pritur ndër shekuj,
Këngës së kalvarit dymijë vjeçar,
Uvertyrë lirie.

*Ballin ua kishe lexuar,
por zemrën dot s'ua zbulove,
tekstin e kishe shkruar,
duke u thënë se ata ishin,
një LEGJENDË.*

ITINERARI I KLONUAR

Civilizimi modern vibron,
Cenon brishtësinë e jetës,
Me logjikën e tredhjes.

Po udhëtoni me trenin e gabuar,
Me itinerarin e klonuar,
Nëpër binarët e lakuar.

Me teleskopin e krisur,
Shihni eklipsin e yllit,
Me(pa)vetëdije salutoni apokalipsin.

Shkronjat si gjithnjë tradhtohen,
Ato nga zemërimi rebelohen,
Dhe sot, nuk shkruajnë dot.

MALLI...

Me gotën me akull,
Mbi tavolinë,
Po shuaja etjen e zjarrit.

Më ishte bërë pasqyrë,
Po shihja miken time të vjetër,
Që jetim kishte mbetur.

Në korridorin enigmatik,
Ishte strukur drita,
Dhe po ndriçonte udhët e nderit.

Aty ishte fillimi i fundit,
Apo fundi i fillimit,
Të lëmshit të (pa) zbërthyer.

Unë piva nga ajo gotë,
Etjen nuk e shova,
Por diçka ndjeva...!?

SFIDO DHE ZGJIDH

I mbyllur,
Në harkun e mendimeve,
Sabotoja lirinë.

Iu qasa labirintit,
Rrugës pa krye,
I humbur në mjegull.

Lirinë e çmendi(me)ve,
Apo geton,
Sfido dhe zgjidh, nëse do.

Mbylle gojën me tapë,
Futi veshët në lesh,
Fat(keq)mirësisë nënshtroju.

**VDESIM PËR TË
MOS VDEKUR**

Qëndro me mua deri në muzg,
Rri dhe dëshmo mynxyrat,
Që nuk prajnë.

Rri me mua dhe shkruaj gjithçka,
Që syri të ka parë,
Dhe zemra të ka ndjerë.

Rri me mua dhe shih,
Se vdesim për të mos vdekur,
Sa të lumtur jemi,
Që jemi ndër të gjallë.

Ballin ua kishe lexuar,
Por zemrën dot s'ua zbulove,
Tekstin e kishe shkruar,
Duke u thënë se ata ishin,
Një LEGJENDË.

SERVIL

I plotë, bosh,
I lodhur, i tredhur,
I çalë i dredhur,
I drejtuar kah Meka apo Roma
I mbetur në udhëkryq.

Refrene, x refrene,
Tablo tragjikomike,
Gurët i shpëtojnë thyerjes,
Taraku i ik vdekjes.

Kryeneç tekesh,
Servil tullacësh,
Robot i ëndrrave të huaja,
Zgjuhuni mjaft fjetët,
Ose flini në rrotat tuaja.

FASHITNIM PLAGËT ME DURIM

Kolltukët e mbarsuar,
Ngelën në korridorin e kujtesës,
Si rekuizita inkuizicioni.

Kokën mbanim të kërrusur,
Të huaj ishim në sofrën tonë,
Po fashitnim plagët me durim.

Turp.
As s'të linin të qetë, të vije, të rrije,
O të ikje i lirë në amshim.
Të gjakosnin e të përdhosnin për trishtim.

Refreneve të mitizimit qiellor,
U erdhi fundi i shumëpritur,
Por e ardhmja na e zgjon kureshtjen.

*Në gjoksin tënd dy yje,
Në sytë e tu dy puthje,
Në mbrëmjen me qiellin e kaltër.*

URAGANI I DASHURISË

Ndali rrahjet zemër,
Mbaje vetëm frymën,
Zotëroje veten në furtunë.

Kë (sh)tu do të shkruhen fatet,
Me majën e lapsit ngjyrë rozë,
Me aromë trëndafili.

Ajo që duhet thënë,
Do ta shkruajë heshtja,
Në sytë tanë.

Në natën e vonë,
Do hapen zemrat,
S'do të pushojë kurrë,
Uragani i dashurisë.

HARKU I MONOLOGJEVE

O yll që ndriçon këtë natë,
Ku treti çupëza ime,
Gjeje dhe ma sill te unë.

Si për ironi atë natë,
Jastëku po më zinte frymën,
Shtrati më ishte bërë varr për së gjalli.

Më zuri agu pa bërë asnjë sy gjumë,
Kam fjetur zgjuar,
Në jorganin e kujtimeve.

Po thith vuajtjet,
Po dehem me gotën e verës,
I mbytur në harkun e monologjeve.

NDËRRIMI I MOTEVE

Ndërrim motesh,
Ndërrim gëzofësh,
Tharë lotësh.

Në qoshe të kërrusur,
Kokulur, të përbuzur,
Në greminë të fundosur.

Vendnumërojmë pa ndalë,
Një plagë na pllakos valë-valë,
Na e bën trupin palë-palë.

Të mbështjellë me petkun e mashtrimit,
Ikin motet, ikin gëzimet,
Lëshon rrënjët zemërimi.

Gotat si për ironi ngrihen,
Ëndrrat plagosen edhe vriten,
Moti i ri të vjetrit ia ndal rritën.

RRUGA X

Të prisja te rruga X,
Çdo sekondë më bëhej ditë.

Të shikoja në mbrëmjet e vona,
Ti ishe e vetmja shpresë e vetmja dritë.

Të përkëdhelja në verën e nxehtë,
Ti ishe lulja me plotë freski.

Të përqafoja në dimrin e acartë,
Zemra jote e butë më dhuronte ngrohtësi.

Të puthja me endje buzët e kuqe,
Në kulmin e rinisë me zjarrin e dashurisë.

TI ISHE AJO

Kishte kohë që në zemrën time,
Një zjarr po më digjte flakë.

Ti ishe ajo.

Kishte kohë që në kokën time,
Ishe fiksuar në kupën e simpatisë.

Ti ishe ajo.

Ti ishe ajo që në mbrëmjen e vonë,
Shove zjarrin e enigmës.

Ti ishe ajo që akrepat i bëre të stepen,
Kur vure në lojë artin e dashurisë.

E tillë je edhe sot.

KASNEC ZEMRASH

Në gjoksin tënd dy yje,
Në sytë e tu dy puthje,
Në mbrëmje nën qiellin e kaltër.

Në sytë e tu dy yje,
Në gjoksin tënd dy puthje,
Në mbrëmjen nën shiun e lehtë.

Përqafiget s'kishin të ndalur,
Llamba e Alajdinit bënte dritë,
Në mbrëmjen e vonë.

Ndalet fryma për një çast,
Kashec zemrash shpërthyen si një vullkan,
Në mbrëmjen e puthjeve të zjarrta.

FAJI JETIM

Ike aq shpejt,
Sikurse rrufeja,
Me lot në sy.

Heshtja jote,
Ishte vuajtja ime.

Vetmia ime,
Ishte pjellë e ikjes sate.

Ulem dhe mendoj,
Agjëroj pa dashje,
As lulet më nuk i ujis.

Ngrita gishtin nga fajtori,
Por mbeti i mpirë,
Faji ishte jetim.

SI SOT

Si sot kurrë më parë,
Shëtisje mbi horizontin
e DASHURISË.

Si sot, kurrë më parë,
Nën kulmin e ylberit, vallëzoje
Vallen e RINISË.

Si sot kurrë më parë,
Vure në lojë
Zjarrin e AMORIT.

Sot si sot,
Le të jetë
JETË E MOT.

*Përshkoje rrugën herët në ditën që lind,
e nesërmja të të gëlltitë,
agimi qetësinë asnjëherë nuk e prish.*

KËNGËT E PAKËNDUARA

Si gjithnjë më pyet se ku isha,
Vallë e kisha humbur rrugën,
Në mos isha bërë tapë,
Dhe nuk po e gjeja dot shtëpinë.

Ecnim, vraponim, pushonim,
Hanim, pinim, këndonim,
Këndova edhe unë,
Që deri dje nuk kisha kënduar.

Këndova me shokë,
Këngët e pakëndueme,
Nga shpirti nxora,
Ndryshkun e moteve,
Që tundej në prehrin e nostalgjisë.

Dhe ti më pyet,
Ku kisha tretur vallë,
Isha aty ku malet përkunden,
Aty ku lumenjtë
Pastrojnë shpirtrat.

PËRSHKOJE RRUGËN HERËT NË DITËN QË LIND

Shikoje agun si vezullon mbi piramida,
E mbi drunjte e gjatë,
Ku era këndon këngët e saja.

Pas majash të thepisura fshehurazi ikën drita,
Ne bëhemi më të gjatë,
Nga siluetat e kuqërremta.

Ndjeje natën e frikshme, intime të mbarsur,
Shiun e rreptë që tredhë ëndrrën
Tënde të pa ëndërruar.

Kthehu sërish në pullazin e mendjes tënde,
Bëji lak çnjerëzisë,
Kotësisë shpalli luftë.

Përshkoje rrugën herët në ditën që lind,
E nesërmja të të gëlltitë,
Agimi qetësinë asnjëherë nuk e prish.

AJO NATË

Tek margaritarët e tu të artë,
Shoh horizontin se si shkëlqen.

Si martirizohen zogjtë në pemë,
Lulet si hapin lehtas petalet.

Edhe pas shumë e shumë puthjesh,
Ende ndjem si në fillimin magjepsës.

Dua sërish që ajo natë të vijë,
Që yjet sërish të na bëjnë roje.

ASKUSH...

Në netët e mbarsuara,
Me peshqeshe,
Vazhdon të fshehësh,
Si lavire,
Truqe leqesh.

E deshe, s'e deshe,
E veshe, s'e veshe,
Epshi të pushton.

Je si top mejdani,
Të godet kush të dojë,
Qeshe apo qave,
Askush s'ndjen,
Askush s'të dëgjon.

PËRMBAJTJA:

- 5. FJALA E REDAKTORIT Mr. Vilson CULAJ*
- 7. VALLJA E ÇMENDUR*
- 8. LABIRINTI*
- 9. GADISHULLI IM*
- 10. TYMI I VOTRËS SË FIKUN*
- 12. DIELLI QË LIND NË PËRENDIM*
- 13. ZBULOJENI DJALLIN QË JU NJEH*
- 15. TAMPON ZONË*
- 17. MOS SHKRUAJ KËSHTU!*
- 18. ANONIM*
- 19. MIKU IM*
- 20. ATË DITË*
- 23. RETRO(PER)SPEKTIVË*
- 24. KËRSHËRI E PANGOPESISË*
- 25. NË EPITAF*
- 26. VETËM POETI.....*
- 27. RRËNJËT ATY NUK KISHIN LINDUR*
- 29. PELLGU I HARRESËS*
- 30. UVERTYRË LIRIE*
- 32. ITINERARI I KLONUAR*
- 33. MALLI...*

34. *SFIDO DHE ZGJIDH*
35. *VDESIM, PËR TË MOS VDEKUR*
36. *SERVIL*
37. *FASHITNIM PLAGËT ME DURIM*
39. *URAGANI I DASHURISË*
40. *HARKU I MONOLOGJEVE*
41. *NDËRRIMI I MOTEVE*
42. *RRUGA X*
43. *TI ISHE AJO*
44. *KASNEC ZEMRASH*
45. *FAJI JETIM*
46. *SI SOT*
48. *KËNGËT E PAKËNDUARA*
49. *PËRSHKOJE RRUGËN HERËT*
50. *AJO NATË*
51. *ASKUSH.....*

Argjend Hasani
SPIRALJA E AGONISË
(Prozë dhe poezi)

Botues
Prishtina PRESS

Redaktor
Vilson Culaj

Disejني dhe faqosja
TRIMDON
Studio Design

Shtypshkronja
“Lena Grafik”

Prishtinë
2016

Ribotim

